

Për:	Operatori Ekonomik: "One-Grup" SH.P.K. me adresë në Junik Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 62.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **29.04.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "One-Grup" SH.P.K. me adresë në **Junik**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi "Rija" deri në dalje të rrugës Xërxë – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2742-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-029-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. Aprovohet**, kërkesa për tërheqjen e Kërkesës për Rishqyrtim, e datës: **29.04.2025**, e parashtruar nga Operatori Ekonomik: "One-Grup" SH.P.K. me adresë në **Junik**, të parashtruar për aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi "Rija" deri në dalje të rrugës Xërxë – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2742-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-029-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **10.04.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi "Rija" deri në dalje të rrugës Xërxë – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2742-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-029-5-1-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **"One-Grup" SH.P.K.** me adresë në **Junik**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi "Rija" deri në dalje të rrugës Xërxë – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2742-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-029-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **10.04.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **29.04.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Operatori Ekonomik: **"One-Grup" SH.P.K.** me adresë në **Junik**, me datë: **30.04.2025**, ka njoftuar se tërhiqet nga ankesa lidhur me aktivitetin e sipërcituar.

Me rastin e informimit lidhur me veprimet e përshkruara si me sipër, Autoritetit Kontraktues mori vendim për Aprovimin e kërkesës për tërheqje nga ankesat e Operatorit Ekonomik ankues duke na lejuar neve si Autoritet Kontraktues që ta vazhdojmë me aktivitetin e prokurimit (i përshtatur si me sipër).

Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si me sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundojë procedura ankimore në këtë fazë, sepse mungon objekti ankimor (**ankesa është tërhequr**) dhe elementet qenësore të ankesës sipas Nenit 62.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>